

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

30 Tetor, 2020

Të Dashur Familjarë të Drejtorise Arsimore të Filadelfias:

Të Martën tjetër, 3 Nëntor, është Dita e Zgjedhjeve. Nuk do të ketë shkollë për studentët dhe kombi ynë do të angazhohet në procesin demokratik të zgjedhjes së drejtuesve të tij të ardhshëm. Ky sezon zgjedhor ka qenë thellësisht përçarës, duke shtuar ankthet dhe streset me të cilat jemi ballafaquar të gjithë për shkak të COVID-19 dhe traumave të tjera. Si drejtori arsimore, është e rëndësishme që të ndihmojmë në shërimin e këtyre ndarjeve duke mbështetur një kulturë të barazisë, përfshirjes dhe respektit për çdo student, familje dhe anëtar të kolektivit.

Drejtorja jone arsimore përfaqëson larminë që është Amerika - larmia e gjinisë, racës, etnisë, fesë, statusit socio-ekonomik, aftësisë, orientimit seksual dhe më shumë. Secili prej nesh do të reagojë ndaj zgjedhjeve ndryshe, bazuar në identitetin dhe vlerat e tij. Por pa marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve, shkollat dhe zyrat tona duhet të jenë strehë të sigurta - pa urrejtje, frikësime, ngacmime dhe frikë.

Të gjithë kemi përgjegjësi të ndihmojmë njëri-tjetrin të ndihen të sigurtë, dhe të vlerësuar. Është e rëndësishme që arsimtarët tanë të krijojnë hapësira të sigurta që ruajnë mirëqenien e studentëve që mund të ndihen të rrezikuar dhe të drejtojnë diskutime në klasë të përshtatshme për moshën dhe të paanshme që i lejojnë studentët të shprehën në mënyra të shëndetshme. Dhe është shumë e rëndësishme që të gjithë të modelojmë se si të merremi me njerëzit me këndvështrime të ndryshme në një mënyrë paqësore dhe tolerante. Këtu janë disa burime të dobishme që ne të gjithë mund të përdorim:

- [Si të Bisedoni me Fëmijët & Adoleshentët në lidhje me Zgjedhjet](#)
- [5 Mënyra të thjeshta për të folur me Fëmijët në lidhje me Votimin](#)
- [Përdorimi i Zgjedhjeve si një Mjet Mësimi](#)

Të folurit i bazuar në urrejtje, ngacmimet dhe sjelljet diskriminuese që zhvlerësojnë të tjerët janë të papranueshme nga studentët dhe personeli kudo në drejtorinë tonë. Nëse jeni dëshmitar, ose jeni në shënjestër të ndonjë prej këtyre sjelljeve, ju mund ta raportoni atë duke telefonuar “Bullying Hotline” në 1-215-400-SAFE ose duke paraqitur një ankesë duke përdorur formularin e gjetur [këtu](#).

Si kujtesë, në Ditën e Zgjedhjeve, të gjitha ndërtesat e shkollës (përveç atyre që shërbejnë si vende votimi) dhe të gjitha Qendrat e Mbështetjes Teknike të Chromebook do të mbyllën. Zyrat tona administrative do të qëndrojnë të hapura. Faleminderit që bëtë pjesën tuaj për të mbështetur mjedise mikpritëse dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë. Ju lutemi kujdesuni, jini të sigurtë dhe mos harroni të VOTONI! Zëri juaj ka rëndësi.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtorja Arsimore e Filadelfias